

“Askujt nuk i shkon mendja tek mungesa e ujit.”

Intervistë me Franz Riegler, Konsulent i Schaumann dhe Aksioner i AUSTRIA Prämix shpk.



◁ Franz Riegler

Ekspert i të ushqyerit dhe bashkë-themelues
i Austria Prämix Albania.

Një kontroll rutinë në laborator për funksionimin e metabolizmit, shpesh herë tregon edhe mungesën e ujit. Ne pyetëm z. Franz Riegler për shkaqet e kësaj.

1-Ju vlerësoni përditë problemet e metabolizmit tek lopët e qumështit – cilët janë treguesit e mungesës së ujit?

Riegler: Si tek çdo kafshë tjetër edhe për lopët, kur nuk kanë marrë ujë mjaftueshëm, kjo çon në përqëndrimin e urinës. Veshkat përthithin ujin për të kompensuar funksionet fiziologjike kundrejt sasisë së pamjaftueshme të ujit në dispozicion.

2-Dhe ju mund ta kuptoni këtë nga rezultatet laboratorike?

Riegler: Në fakt, rezultatet e analizave laboratorike japin tregues të një përqëndrimi të lartë të urinës. Kur bëhet fjalë për kontrollin e një lope të vetme, atëherë me shumë mundësi shkakut është një sëmundje akute e kafshës – më pas shihet se si kjo ndikon në një shkallë më të përgjithshme në fermë.

Por ajo që na bën më shumë përshtypje, është që situata të tilla i hasim shumë shpesh gjatë kontrolleve rutinë të problemeve me metabolizmin.

3-Përse kjo gjë ju bën veçanërisht kaq shumë përshtypje?

Riegler: Në kuadër të inspektimit veterinar të tufave të lopëve të menaxhuara në mënyrë profesionale, në ditët e sotme ka shumë përpjekje intensive, subklike, pra, ende jo në stadin klinik, për të arritur performanca të larta të metabolizmit. Kjo na jep më shumë kohë për të marrë masa. Por, këtu ngrihen disa çështje të tjera në lidhje me metabolizmin e energjisë, yndyrave dhe kalciumit. Për këtë merren mostra urine dhe gjaku nga 5-10 lopë normale, të shëndetshme, për çdo stad prodhimi. Shokues është fakti, që rezultatet tregojnë pothuajse gjithmonë edhe një rritje të përqëndrimit të urinës, edhe pse ky nuk ishte qëllimi fillestar i analizës së kërkuar nga fermeri apo veterineri.

4-Cili mendoni se është shkaku që fshihet pas kësaj?

Riegler: Rezultatet laboratorike të përgjithshme shpesh tregojnë se lopët nuk marrin ushqim mjaftueshëm. Kur përveç kësaj, na rezulton dhe përqëndrim i lartë i urinës, kjo mund të tregojë se lopët nuk marrin mjaftueshëm ujë. Dihet që mungesa e ujit sjell reduktimin e konsumit të ushqimit. Për çdo kg lëndë të thatë, lopa ka nevojë për rreth 4 - 5 liter ujë. Pra, uji është më i rëndësishëm se sa mendohet zakonisht.

5-A shfaqet njësoj mungesa e ujit në të gjitha stadet e prodhimit?

Riegler: Sipas të dhënave tona, çdo fazë e prodhimit është e prekur, por besojmë se mungesa e ujit është e theksuar veçanërisht në periudhën e tharjes.

6-Si e shpjegoni ju këtë?

Riegler: Për këtë duhet të bëhet një analizë e fermës. Shpesh herë veterinerët konfirmojnë dyshimet e tyre për një furnizim të pamjaftueshëm me ujë në fermë. Më së shumti është një problem teknik ose strukturor. Për shembull, problemi qëndron tek numri, vendosja ose shpejtësia e prurjes së pajisjeve të ujit. Lopët në periudhën e tharjes duket se janë më të prekurat nga kjo. Ndoshta kjo ka të bëjë me faktin se shpesh herë ato vendosen përkohësisht në zona të stallës me mundësi të parehatshme për të pirë ujë duke bërë veçimin nga pjesa tjetër e tufës që mund të jenë në laktacion.

Si përfundim, fermeri dhe veterineri duhet t'i kërkojnë së bashku shkaqet. Ne si konsulentë specialistë mund t'ju japim vetëm një shtysë. Vetëm kështu mund të shmangen plotësisht problemet me furnizimin e ujit në stallë.